

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI – NDËRTIMI I PLATFORMËS KOMBËTARE PËR GRATË SIPËRMARRËSE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Ne, përfaqësuesit e shoqërisë civile (shoqatat e biznesit, organizatat jo-fitimprurëse, ofruesit e shërbimeve të biznesit dhe trajnimit, Dhomat e Tregtisë dhe zyret e tyre rajonale; institucionet akademike dhe organet e tjera civile), duke vepruar në zhvillimin dhe avancimin e grave sipërmarrëse në Kosovë dhe kundër çdo forme të diskriminimit gjinor kemi zhvilluar platformën e grave sipërmarrjes në Kosovë (më tej - Platforma), e cila është instrument modern dhe efektivë për të gjetur zgjidhjet e detyrave komplekse dhe masive dhe ka këto avantazhe:

- ✚ Lejon të marrë në konsideratë interesat e të gjithë pjesëmarrësve të shoqërisë civile, të interesuar në zhvillimin e sipërmarrjes së grave në Kosovë, zhvillimin dhe realizimin e veprimeve komplekse për përmirësimin e kushteve për fillimin dhe zhvillimin e biznesit;
- ✚ Ndërton një bazë për zhvillimin e dialogut publiko-privat dhe partneritet;
- ✚ Ofron reduktimin e barrierave të grave sipërmarrëse dhe përmirësimin e klimës të biznesit;
- ✚ Promovon rritje të qëndrueshme dhe cilësore të ekonomisë dhe të cilësisë së jetës të qytetarëve.

Qëllimi kryesor i Platformës është avancimi i grave sipërmarrjes në Kosovë nëpërmjet partneritetit të sektorit publiko-privatë

Platforma aktuale është një marrëveshje e përbashkët mes përfaqësuesve të shoqërisë civile të Kosovës dhe është e bazuar në parimet demokratike të partneritetit dhe lirisë të shprehjes së vullnetit.

Platforma do të shërben që të bashkohen veprimet e shoqërisë civile dhe autoriteteve shtetërore për zhvillimin e mëtejshëm të grave sipërmarrëse në Kosovë.

Ne kemi përcaktuar drejtimit kryesore të zhvillimit të sipërmarrjes së grave në Kosovë:

1. Për të nxitur strukturat qeveritare në zhvillimin dhe implementimin e legjisllacionit dhe dokumenteve të politikave ekonomike që synojnë të krijojnë kushte të barabarta për zhvillimin e sipërmarrësisë së grave.
2. Për të inkurajuar pavarësinë ekonomike të grave si një dispozitë e zhvillimit të mëtejshëm të grave sipërmarrëse nëpërmjet rritjes së mbështetjes financiare dhe linjave të veçanta kreditore për gratë, të zhvillimit të sipërmarrësisë nëpërmjet sistemit të fondeve garantuese nga buxheti i konsoliduar i Kosovës për gratë.
3. Për të nxitur trajnimin e grave në aftësitë e biznesit, teknologjitë e reja, puna me internet dhe të përmirësojë kualifikimet e grave sipërmarrëse nëpërmjet zhvillimit të paketave të trajnimit dhe shërbimeve të konsulencës me ndihmën e institucioneve qeveritare dhe organizatave jo-qeveritare.
4. Për të zhvilluar rrjete të sipërmarrësisë dhe rrjete të shoqatave të biznesit të grave dhe partneritetin e tyre me institucionet qeveritare dhe sektorin privat.

Veprimet tona janë të drejtuara për të kapërcyer pengesat dhe problemet serioze që krijojnë një hendek në mes të orientimit të grave për sipërmarrësi dhe mundësi reale.

Veprimet tona janë të drejtuara për të promovuar rolin e gruas në shoqëri dhe zhvillimin e sipërmarrësis të grave në Kosovë, që do të jetë motivim i zhvillimit të vendeve të reja të punës.

Veprimet tona janë të drejtuara për të forcuar potencialin e grave sipërmarrëse në rajon dhe të zgjerojnë qasjen e tyre ndaj resurseve dhe kredive.

Platforma e tanishme do të shërbejë si bazë e planit të veprimeve për periudhën 2013-2015: “Gratë Sipërmarrëse - Motor për krijimin e vendeve të punës në Evropën Jug-Lindore”

Platforma e grave sipërmarrëse në Kosovë është zhvilluar dhe nënshkruar nga përfaqësuesit e mëposhtëm të shoqërisë civile:

Nr	Emri i OJQ-ve/Institucionet
1	Women's Business Association (SHE-ERA)
2	Kosovo Women Network (KWN)
3	Kosovo Gender Study Center
4	Kosovo Women Economic Chamber
5	Kosovo Business Alliance (AKB)
6	Kosovo Export Association (KEA)
7	Kosovo Textile Association (KTA)
8	Company 21 (Media House)
9	University of Prishtina - Economy Faculty
10	College "GLOBUS"
11	College "ILIRIA"
12	College "UNIVERSUM"
13	Qeliza Network
14	Community Building Mitrovica (CBM)
15	Development Education Foundation
16	NGO "Lulebora"
17	NGO "FATJONA"
18	Women for Women - Kosovo
19	NGO "Gruaja Bashkohore"
20	NGO "ZANA"
21	Youth Education Trust
22	Women Center "ATO"
23	Women Organization "BARAZIA"
24	NGO "Gruaja Hyjnore"
25	NGO "Ruka Ruci"

26	Association Women with Disabilities
27	Protection Women Center
28	Medica Kosova
29	NGO "MWAHR"
30	NGO "LUNA"
31	NGO "FANA"
32	NGO "Parajsa Jonë"
33	TOP RADIO
34	Association for Education and Family Welfare
35	NGO "One to One"
36	NGO "Dora Does"
37	NGO "IKEBANA"
38	NGO "PREHJA"
39	NGO "ALMA"
40	NGO "KALABRIA"
41	NGO "ARTPOLIS"
42	NGO "Kalabria"
43	NGO "Gratë e Krushës"